



C.nr.522/16

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me sekretaren juridike Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-konstitucionale te inicuar me padine e paditëses [REDACTED] ne Ferizaj rr. [REDACTED], kunder te paditurive [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, per borxh, jashte séance me date 30.09.2016, merr ketë:

A K T G J Y K I M
-PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-

APROVOHET kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] ne Ferizaj rr. [REDACTED], si e bazuar.

DETYROHEN të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] i nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, që paditëses t'ia paguan shumë prej 795.00€, me kamat ligjore nga dita e paraqitjes se padisë e deri ne pagesen definitive, si dhe taksën gjyqësore për përpilimin e këtij aktgjykimi në shumë prej 15.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

OBLIGOHET paditësja që të paguan taksën gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 15.00€, menjëherë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurve, për shkak se te paditurit në bazë të Marrëveshje për Kredi nr.KOFE-002602-008, nuk kanë përmbushur obligimet që i kanë pasur ndaj paditëses në bazë të kësaj kontrate për kredin.

Gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material, për borxhin nga ana e të paditurve.

Gjykata, te paditurve me datë 13.08.2016, i ka dorëzuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por të paditurit brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk kanë ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tyre nëse e kundërshtojnë apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se të paditurit kanë pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin për përgjigje ne padi (e cila u është dorëzuar me rregullë), gjykata bazuar ne nenin 150.6 te LPK-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjyqësore.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 te LPK-së, që përjashton mundësin për axjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne bazë të nenit 277 te LMD-se, duke qenë se për paditësin lartësia e borxhit, ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurit për kompensimin e shpenzimeve te procedurës kontestimore ne baze te nenit 452.1 te LPK-se, ndërsa paditësin në bazë të UA nr.2008/2 te K.GJK-se, për unifikiminë e taksave gjyqesore.



GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.522/16, me datë 30.09.2016



Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankësa ne afat prej 15 ditesh ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme e pranimit te ketij aktgjykimi.

